



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 07.07.2022.
2. Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar ndërmjet shoqërisë Anio Oil & Gas sh.a., me të licencuarin Albpetrol sh.a., lidhur me detyrimin e instalimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, si dhe përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar, çmimit të energjisë dhe detyrimin total që shoqëria Anio Oil & Gas sh.a., ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a..
3. Mbi kërkesën e shoqërisë "ALBPETROL" sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë "ALBPETROL" sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë "NRG Power" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë "ALB-ENERGY" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.